



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 28 korrik 2026, në mbledhjen e VII-të (shtatë) -e rregullt, mandati VIII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Isak Shabani, Haki Rudari, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Qëndresë Hajrizi, Enis Shabani, Ekrem Rrahmani, Mimoza Abdullahu), ndërsa mungoi Alisa Jetullahu. (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin; z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës, Ditjona Statovci U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës-DA; Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF; Lirie Hoti-Rama U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR; Saranda Stublla-Uka U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Behram Latifi U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, besoj që rendi i ditës dhe materialet ju janë dërguar me kohë, (*lexon pikat e rendit të ditës sipas thirrjes*), andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës për këtë mbledhje, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa e mbajtur më 26.06.2026

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalë, pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa e mbajtur më 26.06.2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizmin e projekteve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit dhe i këtij Komiteti, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës unë kam marrë një e-mail nga shefi i Grupit të këshilltarëve të LDK-së i cili ka kërkuar që raportimi i Kryetarit të Komunës sipas kësaj pike të rendit të ditës të jetë me shkrim, dhe unë këtë kërkesë e kam dërguar te Kryetari i Komunës, mirëpo në bazë të informatave që kam nga e kaluara lidhur me këtë çështje është se kryetari i Komunës vetëm raporton në mbledhjen e Kuvendit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e përmendi edhe Kryesuesi i Kuvendit që ne kemi kërkuar edhe raport me shkrim lidhur me këtë pikë sepse ne e dim që Ligji e potencon që Kryetari raporton para Kuvendit, mirëpo do të ishte mirë ta kemi edhe me shkrim një raportim të tillë se çka do të raportoj ose prezantoj Kryetari në mbledhjen e Kuvendit. Ne e dim që gjatë prezantimit ai mund të përmend rrugë, emra, projekte e të tjera, andaj është paksa problem të evidentohen të gjitha nga ana jon si Kuvend prandaj do të ishte më mirë dhe më e rrugës që ne anëtarët e Kuvendit të kemi një raport të shkruar në mënyrë që të përgatitemi paraprakisht. Përndryshe nga dhjetori 2024 nuk është bërë raportim i tillë në Kuvend nga ana e Kryetarit edhe pse jemi në dijeni se Ligji e obligon për një raportim të tillë 2 herë brenda vitit, kurse në vitin 2025 nuk ka pasë një raportim. Kështu që nuk di në çfarë mënyrash do të mund t'i përgjigjemi ne Kryetarit sepse ai është për çdo ditë në punë dhe i dinë punët që kryhen ose që janë në proces, prandaj normale që është dashtë të kemi materialin e këtij raportimi në formë të shkruar, ose përndryshe ka mund të jetë i publikuar ai raport në ueb faqe të Komunës ashtu siç e kanë bërë Drejtoritë edhe pse jo aq mirë këto por që të paktën e kanë raportin e punës dhe e kanë të publikuar, kurse te Kryetari i Komunës nuk ka as raport të shkruar e as të publikuar.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, në bazë të asaj që unë jam interesuar dhe kam pyetur rreth kësaj çështje është se nga praktika e kaluar nuk është bërë raport në formë të shkruar por është prezantuar drejtpërsëdrejti në Kuvend. Përndryshe meqë në këtë mbledhje kemi edhe raportin financiar të Komunës së Podujevës janar-qershor 2026 dhe aty janë të përfshira të gjitha ato projekte të kryera dhe që janë në realizmin apo që janë shpenzuara mjete gjatë kësaj periudhe kohore, prandaj urdhëroni nëse edhe ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit që në mbledhjen e caktuar për datës 30.07.2026 Kryetari i Komunës të raporton në Kuvend realizmin e projekteve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet Raportimi i Kryetarit të Komunës lidhur me realizmin e projekteve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar - qershor 2026

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth Raportit në fjalë, theksoi, materialin e kësaj pike të rendit të ditës besoj e keni pranuar me kohë dhe keni pas mundësi dhe kohë ta lexoni dhe analizoni secili.

Buxheti total i Komunës për vitin 2026 është 34,778,954.00€, dhe shpenzimi i këtij buxheti gjatë kësaj periudhe kohore është mbi 18 milion euro, konkretisht 18,151,593.75€ dhe atë nëpër kategori të ndryshme e që për paga dhe mëditje 11,740,956.22€ , pastaj për mallra dhe shërbime 1,392,886.16€, për shpenzime komunale 504,817.00€, mandej për subvencione dhe transfere janë shpenzuar 891,670,50€, ndërsa për investime kapitale janë shpenzuar 3,621,254.87€.

Të gjitha shpenzimet mund t'i gjeni në raport dhe atë sipas kodeve ekonomike të ndryshme dhe po ashtu nëpër kategori të ndara, kurse realizmi i të hyrave vetanake për këtë periudhë kohore është tejkalim në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025, pra është 1,400,639.97€ duke përfshirë edhe donacionet.

Gjatë seancës së Kuvendit pres diskutime dhe komente për të cilat nëse është e nevojshme mund të jap më në detaje për secilin transaksion dhe kod buxhetor.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë raport financiar dhe të njëjtin e rekomandojmë për seancën e radhës së Kuvendit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim që ky raport t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e radhës që është thirrë për datën 30.06.2026, shpresojmë të ketë diskutime dhe sqarime dhe përgjigje nga ana e Drejtoreshës në ato shqetësime që do të ngritën gjatë seancës së Kuvendit.

Është për t'u vlerësuar të paktën mënyra se qysh na dërgon këto raporte, madje edhe në rastet e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare duke përfshirë edhe kërkesat për dokumente shtesë. Mirëpo ky raport tani është më i pasur dhe më i kompletuar se sa më parë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë kam një pyetje për drejtoreshën e DBF-së sa i përket këtij raporti financiar. Shuma totale e buxhetit fillestar e aprovuar për vitin 2026 sipas strukturës së paraqitur thuhet se paga dhe mëditje janë të parapara 19,925,293.00€, kurse tani në këtë gjashtëmujor të parë të vitit 2026 shpenzimet në këtë janë 11,740,965.22€, andaj në bazë të kësaj dhe nëse vazhdohet në këtë trend për paga dhe mëditje shuma deri në fund të vitit do të arrij mbi 22 milion euro, andaj pyetja është se a mund të paraqet rrezik kjo çështje në të ardhmen.

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoreshë e DBF, theksoi, lidhur me këtë që Kryesuesi e paraqiti dua t'ju sqaroj se në këtë shpenzim për paga dhe mëditje është përfshirë edhe paga e 13-të që është shpërndarë në fillim të këtij viti dhen kjo e bënë atë diferencën, përndryshe në raport të planifikimit me shpenzimin jemi pak më pak sepse edhe ashtu gjithherë planifikohet ashtu për shkak se ka projekte më të rëndësishme dhe në fund të vitit Ministria e Financave në bashkëpunim me Thesarin e plotëson atë minusin e pagave, mirëpo në të ardhmen do të mundohemi të zvogëlojmë këtë diskrepancë në mes planifikimit dhe shpenzimit në kategorinë e pagave, përndryshe kjo ka ndodh për shkak të pagës së 13-të e që janë klasifikuar paga ose shtesa të performancës ku shuma ka qenë afër 2 milion euro, prandaj kjo është ajo diferenca në këtë tregues.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, ju falënderoj e nderuar Drejtoresh për sqarimin e dhënë, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e radhës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim/shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguara me thirrjen e mbledhjes.

4. Raport i monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar janar - qershor 2026)

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij Raporti, theksoi, pra si pikë të rendit të ditës për këtë mbledhje dhe seancën e radhës së Kuvendit kemi edhe Raport i monitorimit të Kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, periudha e raportuar janar - qershor 2026, andaj kërkoj nga ana juaj t'ia rekomandoni Kuvendit për shqyrtim.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë e kam paksa për qejfi këtë temën e pronave publike komunale ose të qytetarëve. Ky raport jep shumë pak sqarime, do të thotë nuk pasqyrohen të gjitha pronat që ne ta dimë, pra nuk janë të specifikuarat pronat me numër, cila parcelë, cila pronë dhe kujt i është dhënë në shfrytëzim, sa vite dhe mungesë e informatave tjera rreth kësaj çështje, andaj nuk e di përse po i ikin këtyre çështjeve. Po ashtu në seancën e kaluar Kryetari i Komunës premtoi që në këtë seancë do t'i sjellim për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim edhe pronat tjera që janë në kuadër të listës së veçantë që e kemi miratuar në këtë Kuvend për vitin 2026, por që është kapërcyer ai premtim dhe nuk janë sjellë si pika të rendit të ditës edhe pse ka qenë në listë që një numër të tyre deri në muajin qershor të sjellën në Kuvend për shqyrtim dhe marrje të vendimeve.

Ky raport është paksa i shkurtër, me të dhëna të mangëta, as nuk figuron shuma e mjeteve sa ka përfutur Komuna nga qiratë, as sa kontrata janë të lidhura, sa prona dhe cilat janë të uzurpuara, në mënyrë që të jemi të informuar dhe të dimë kush ka hyrë në borxhe ndaj Komunës, kush ka uzurpuar dhe çështje tjera, qoftë edhe unë nëse jam uzurpues i ndonjë prone duhet të tregohet, përndryshe ai që nuk guxon t'i paraqet emrat e tyre vetëm më sjellëni listën me emra mua dhe unë në foltore do të dal t'i ceku të gjithë me emra qoftë uzurpuesit, qoftë borxhlinjtë qoftë të tjerët, andaj nuk e di përse nuk po kryhet kjo punë, madje për këtë edhe drejtoresha e DPKGJ e din që Auditori në raportin e tij për pronat në Komunën e Podujevës, Komunën e ka vë shumë keq (shkret).

Shpresoj që në të ardhmen raportet e tilla të përgatiten më mirë, përndryshe edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim që ky Raport t'i rekomandohet Kuvendit për seancën e radhës ku natyrisht se do të diskutohen edhe çështje tjera rreth kësaj teme.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, sa për sqarim parafolësit, ky raport nuk ka të bëjë me uzurpimet por ka të bëjë me raport të dhënies së pronave në shfrytëzim ashtu qysh parashihet me Ligj dhe ne kemi sjellë një raport të tillë për këtë periudhë kohore i cili me theks parasheh raport për shkëputjen kontrata për çka duhet të raportohet në Kuvend e që ne i kemi përfshirë numrin e kontratave që janë shkëputur, prandaj e them se nuk ka të bëjë me uzurpime.

Sa i përket listës së përgjithshme të pronave komunale, ajo është e publikuar në ueb faqe të Komunës, po ashtu në këtë drejtim jemi duke punuar edhe me Departamentin e Pronës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ku vitet e ardhshme secila pronë e Komunës do të jetë në atë listë me të gjitha të dhënat e sakta qoftë llojin e pronës, statusin e pronës dhe të gjitha të dhënat tjera do të jenë të publikuara.

Sa i përket pyetjes përse nuk i kemi sjellë në Kuvend si pika të rendit të ditës për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim pronat komunale të cilat janë pjesë e listës së veçantë, unë në fakt në fundin e seancës së kaluar kam munguar për shkaqe shëndetësore por ju kam dëgjuar që e keni ngritur së bashku me Kryetarin e Komunës çështjen e Stadiumit të Qytetit, mirëpo arsyeja përse nuk e kemi sjellë me kohë atë pronë është sepse Komuna ka hapë procedurë gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë sa i përket pronarit të pronës ose një vrejtheje që figuron në fletën poseduese për çka ju kam dhënë sqarime disa herë që aty është e shkruar "...jepet në shfrytëzim KF Llapit...." e që është pa asnjë vendim, në fakt ne kemi kërkuar se a ka Vendim të Kuvendit sepse zakonisht në raste të tilla një pronë

duhet të kaloj përmes vendimit të Kuvendit, nuk kem i gjete një vendim të tillë dhe pastaj kemi iniciuar procedurën në Gjykatë. Përndryshe sipas Ligjit përkatës për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, janë disa rregulla të cilat duhet të plotësohen e një ndër to është që një pronë nuk mund të jepet në shfrytëzim në qoftë se është në kontest gjyqësorë, andaj për këtë arsye nuk e kemi sjellë në Kuvend atë pronë, pa u përmbyllë kontesti gjyqësorë, dhe kjo është arsyeja përse nuk janë proceduar për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim lokalet në Stadiumin e Qytetit sepse siç e ceka paraqitja e kësaj çështje në Gjykatë e pamundëson këtë. Ne po presim verdiktin e Gjykatës dhe në momenti që Gjykata thotë t'i hiqet ajo vërejtje dhe ajo pronë kthehet në pronësi të Komunës, ne do të veprojmë sipas ligjit dhe do ta sjellim në Kuvend për dhënie në shfrytëzim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e nderuar drejtoresh e DPKGJ thuhet paraqet raport..., ju nuk është dashtë që këtë raport ta bëni vetëm për kontratat e shkëputura ose ato që janë aktive, por është dashtë të bëni një përmbledhje të gjithave që ta dimë sa prona janë të uzurpuara cilat janë me kontrata, cilat janë pa kontrata. Sa i përket Stadiumit, nëse ju e keni sjellë në Kuvend dhe na keni kërkuar ta votojmë listën e veçantë të pronave që planifikohen të jepen në shfrytëzim në këtë vit, dhe madje keni caktuar afate që në janar-mars të sjellët në Kuvend, nëse ka qenë çështja për Gjykatë është dashtë të mos përfshihen në atë listë të veçantë fare. Pastaj kemi edhe çështjen tjetër, nëse ajo pronë nuk sjellët në Kuvend dhe është në gjykatë, do të duhej që Komuna të ndërmerr diçka në atë pronë sepse ai perona atje po e shfrytëzon atë dhe madje po j'ua lëshon edhe personave tjerë me qira pronën komunale dhe po përfiton para e pastaj na tregon neve se qysh po ka sukses, qysh po investon aty sikurse që KF Llapin e ka privatizuar në SHPK, përndryshe po të jetë ashtu, edhe unë kam biznes dhe po ju kërkoj të para 10 mijë ose 20 mijë euro Komunës sepse jam i suksesshëm e gjëra të ngjashme, prandaj e them se Komuna është dashtë pak më ndryshe ta trajtoj këtë situatë, apo nëse ai është më i fortë se Komuna dhe ky Kuvend le të vazhdoj, por nuk është e drejtë kjo. Unë nuk e di këtë problematikë, këtu Kuvend ka pasë në atë kohë, nëse nuk ka letër incizimet janë edhe do të duhej të gjindej nëse i është dhënë nga ndokush në shfrytëzim apo a ka ndonjë vendim të Kuvendit për këtë çështje, apo eventualisht është fshehur ndonjë letër ndokund sepse siç thuhet në popull (nëse pitja është ngrënë tepsia ka mbet), pra të shikohet se a është sjellë në Kuvend ajo pronë, a është shqyrtuar, a është votuar, të shikohen procesverbalet, pra të shikohet qysh është vë ajo vërejtje në fletë poseduese, qysh e ka marrë atë pronë në shfrytëzim, qysh e shfrytëzon si dhe çështje të ngjashme rreth asaj prone.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, i nderuar Ekrem, sipas Fletës poseduese në vitin 2017 i është dhënë në shfrytëzim dhe tani ai person thirret në atë që e ka në shfrytëzim atë parcelë, nuk ka periudhë të caktuar kohore për këtë. Unë në vitin 2017 nuk kam qenë as drejtoreshë e Drejtorisë e as në ndonjë funksion në Komunë. Kemi kërkuar Vendim të Kuvendit të Komunës por nuk kemi gjet, mirëpo nëse dikush mendon që unë e prekë atë vërejtje e cila figuron në Fletën poseduese ta harroj atë sepse nuk e preku, nuk ndërhyjë pa një vendim të Kuvendit, përndryshe për atë edhe e kemi dërguar në Gjykatë dhe po presim derti sa Gjykata të jep një verdikt final, në mënyrë pastaj të mundësohet heqja e asaj vërejtje në Fletën poseduese, pra unë e as askush në DPKGJ nuk mund të ndërhyjë në Fleta poseduese e as të barët prona pa pasur një vendim ligjore, kështu që kemi hasë në atë vërejtje, na ka bllokuar ajo vërejtje, ai peron thirret në atë që e ka në shfrytëzim, vendim për një gjë të tillë nuk kemi gjet, çka është bërë në vitin 2017 ata që kanë qenë le ta marrin përgjegjësinë, jo ne.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk e potencova unë përgjegjës askënd, përgjegjësinë le ta merre ai që e ka bërë, por vetëm ta dim ne kush e ka bërë dhe t'ia vëmë emrin këtë punë, me kaq kryhet kjo, nuk më intereson fare se kush mund të jetë, qoftë edhe familjare i imi nëse është.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e DPKGJ, sërish replikë me parafolësin, theksoi, sa i përket asaj se kush e ka bërë, nuk di çka mund t'ju them sepse nuk jam hetues për këtë çështje.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dikush tjetër dëshiron fjalën për diskutim, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim/shqyrtim të kësaj pikë të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguara me thirrjen e mbledhjes.

5. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, Njësia kadastrale

P-71712062-00244-4 në sipërfaqe 495m², Zona Kadastrale Podujevë me qëllim të realizimit të projektit “Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale”

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrale dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, si pikë e rendi të ditës tani kemi edhe propozim vendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, Njësia kadastrale P-71712062-00244-4 në sipërfaqe 495m², Zona Kadastrale Podujevë me qëllim të realizimit të projektit “Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale”, projekt ky i cili është duke u zhvilluar në atë pjesë ku 495m² janë në pronës dhe menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Komuna ka interes ta kthejë në pronësi të Komunës sepse një pjesë e projektit është në, pronësi komunale dhe parashihet që krejt ajo pjesë të kthehet në pronësi të Komunës, andaj ju ftoj ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së i rekomandojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet më 30.07.2026.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, dua ta pyes drejtoreshën e DPKGJ se kur ka ardhë kjo parcelë në Kuvend për miratim para se të fillojë ai projekt, është sjellë një pronë me një numër tjetër të cilën e kemi votuar këtu në Kuvend dhe është nisë ai projekt, mirëpo kohëve të fundit po sa po fillohen disa projekte më nuk po duhet pastaj prona e kujt është. Pra ai projekt thuajse ka përfunduar, mirëpo a dini se çka do të ndodhte pastaj nëse AKP do ta vënte në shitje dhe ta shiste, prandaj nuk e di përse po hymë në situata të tilla kur e kemi Drejtorinë përkatëse e cila do të duhet t'i shikonte personat në emër të kujt janë dhe me kohë t'i sjellë në Kuvend për votim për shpallje në interes publik.

Përndryshe unë e kam parë atë parcelë ku gjysma ishte objekti i Qendrës së Regjistrimit Civil, gjysma ishte andej dhe vazhdonte edhe më tutje, do të thotë se edhe QRC nuk ishte mirë me dokumentacion të pronës, andaj nuk e di përse po vazhdohet me këtë punë në këtë formë.

Pse nuk i shikojmë ne si Komunë me kohë këto gjëra dhe t'i marrim pronat t'i bartim në pronë komunale dhe objektet përkatëse, mirëpo vijmë në një situatë të tillë ku gjysma e objektit është në, pronë të një ish Ndërmarrje të para luftës “Mekanizmi”, prandaj a nuk është ndarë ajo pronë apo tani keni i filluar regjistrimin e pronës dhe është gjete si vërejtje dhe nuk ka mund të regjistrohet, apo pse ndodh kjo kërkoj të më shpjegohet në mënyrë të sinqertë.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, AKP nuk bënë shitje dhe nuk i vë në privatizim pronat pa e njoftuar paraprakisht Komunën se a ka interes për të marrë atë pronë apo jo, kjo ngase e ka me rregulla ligjore, do të thotë çdo pronë që ka planifikim për ta vë në privatizim e që në këtë rast këtë pronë për të cilën po flasim nuk e ka vë në privatizim dhe neve të paktën nuk na ka njoftuar, mirëpo kur është nisë projekti në atë kohë është caktuar lokacioni, dhe ne tani kemi hasë që një pjesë e projektit shtrihet në këtë parcelë dhe që tani Komuna ka interes ta shpronësoj këtë parcelë dhe ta kthej në pronësi të Komunës e pastaj të bashkohet me parcelën tjetër që është në emër të Komunës.

Asgjë të keqe nuk ka në këtë aspekt, por vetëm ka interes Komuna mirëpo për t'i zhvilluar procedurat e shpronësimit dhe për t'iu drejtuar Qeverisë së republikës së Kosovës për shqyrtim të mëtejme neve na duhet ta shpallim interes të përgjithshëm publik me vendim të Kuvendit në mënyrë që ne pastaj të mund t'i nisim procedurat e shpronësimit dhe ta kthejmë atë parcelë në pronësi të Komunës, prandaj për këtë e kemi sjellë këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim në Kuvendine Komunës dhe po shpresoj që do ta përkrahni.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, deri në një masë e di qysh shkojnë procedurat e shpronësimit e që një ndër ato është edhe pagesa e 20% që i barrë Komunës ndaj AKP-së e të tjera, mirëpo unë më shumë pyeta pse kur është sjellë për caktim të lokacionit para 3-4 viteve ka qenë një parcelë me numër tjetër kurse tani është sjellë kjo parcelë që ka numrin 00244-4 kurse ajo në atë kohë ka qenë 00244-2.

Pra në atë kohë a nuk e kemi ditë si Komunë që është pronë e AKP-së ose që është edhe ajo parcelë e ta kryenim në atë kohë, apo pse është sjellë tani.

Ndërsa sa i përket asaj se a e përkrahim ta shpallim në interes të përgjithshëm publik të Komunës, ajo nuk diskutohet, natyrisht se ne e përkrahim, madje do të doja të kishte edhe më shumë prona të tilla që ti shpallim interes të përgjithshëm publik dhe t'i bartim në pronësi të Komunës.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, i nderuar Ekrem nuk e di sa je i informuar, por gjatë mandatit të kaluar për herë të parë Komuna e Podujevës ka shpronësuar gjithsejtë rreth 60 hektar tokë prej AKP-së dhe i ka bartur në pronësi të Komunës.

Në rregull, e pranoj që kjo na ka ikë parcelë, por nuk është që vetëm kemi thënë hajtë ashtu të ndërtojmë sepse edhe atë parcelë do ta përfshinin në atë proces ashtu siç i kemi përfshirë edhe parcelat tjera e për disa prej tyre ende janë duke u zhvilluar procedura të shpronësimit për të cilat janë bërë miratimet e kërkesave për shpronësim, mirëpo kjo na ka ikë si parcelë dhe tani e kemi vërejtur dhe kemi interes ta shpronësojmë për ta kthyer në pronësi të Komunës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i di këto e nderuar drejtoresh sepse kam marrë pjesë në çdo votim dhe nuk është ajo që i ka bërë Komuna por i ka bërë Kuvendi i Komunës.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj piket të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

6. Propozim Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2026-2028.

-Raporti i diskutimit publik për këtë dokument

z.Fahri Restelica, Nënkyetar i Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij Plani, ndër të tjera theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi propozim Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Podujevës 2026-2028, përfshirë edhe Raportin e diskutimit publik për këtë dokument, plan ky i cili është hartuar nga Niveli qendrorë dhe ju është dërguar Komunave që t'i adaptojnë sipas nevojave dhe specifikave që kanë dhe ne si Komunës e kemi adaptuar sipas nevojave që kemi menduar se janë të nevojshme të përfshihen në këtë Plan dhe shpresojmë që me miratimin e këtij plani do të funksionalizojmë dhe do t'i fusim në funksion të gjithë mekanizmat lokal përkatës riintegrim dhe riatdhesuar dhe po shpresoj që do të ec si Plan dhe do të realizohet sa më shumë që të jetë e mundur. Andaj ju ftoj ta përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancën e datës 30.07.2026.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj piket të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguara me thirrjen e mbledhjes.

Duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë rreth kësaj mbledhje, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar dhe njëkohësisht i njoftuar se Konstatimet e rekomanduara në bashku me materialet përkatëse nga kjo mbledhje sot do t'ju procedohen / dërgohen anëtarëve të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Arbrim Idrizi

Nr.Prot.01-060/01-0044075/26

Podujevë,

28 korrik 2026

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Isak Shabani